



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 22.

Prishtinë, më 18.11.2011 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Munguan: Agim Kuleta

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësues EUSR Visar Bivolaku, përfaqësues USEP Maja Markovic, përfaqësuesit nga ICO Suzana Saljih. M. Montic, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-71 për Sistemin e Adresave, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme. Siguri, dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Qeverinë e Kosovës. nr 04/ L-68, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/952 / L-61 për shitjen e banesave për të cilën ekziston e drejta banesore me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor me ekspertizën e kryer të ekspertit të jashtëm nga Komisioni Evropian.

7. **Shqyrtimi i detyrave të identifikuara të Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012,**
8. **Të ndryshme.**

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua me shumicë të votave.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluara.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 28.10.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-71 për Sistemin e Adresave, me raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-71 për Sistemin e Adresave, të propozuara nga Komisioni Funksional.

Kërkoj nga anëtarët të deklarohen nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Rasim Demiri- në diskutimin e tij tha se grupi Parlamentar 6+ ka bërë analizë të thuktë lidhur me Projektligjin për Sistemin e Adresave. Mendon se janë vonuar në paraqitjen e amendamenteve të tyre në komisionin funksional për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrje të FSK-së .

Njëherit ai propozoi që Komisioni sot duhet të shqyrtoj amendamentet e grupit Parlament 6+, me tekstin si në vijim:

Amandamenti 1

Neni 6, pas fjalise ' Gjuhes Zyrtare ', te shtohet fjalia ' dhe ne gjuhet zyrtare te komunave'

Amandamenti 2

Neni 21 , paragrafi 4 , pas fjalës 'tabelat ' te shtohet fjalia ' dhe emrat '

Kryesuesi - theksoi se amendamentet e Grupit Parlamentar 6 +, për arsye të jo korrektësisë së tyre të cilat është dashur të procedohen në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri, dhe konsideron se Komisioni të njëjtat nuk ka mundësi ti shqyrtoj.

Kryesuesi murr qëndrim dhe propozoi që Komisioni të votojë amendamentet e Komisionit funksional dhe me shumicë votash nxori këtë:

REKOMANDIM

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-71 për Sistemin e Adresave dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri, dhe Mbikëqyrje të FSK-së, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, të propozuara nga Komisioni Funksional

Ai theksoi se amendamentet e komisionit Funksional lidhur me këtë projektligj janë shqyrtuar nga Fondit Monetar Ndërkombëtar FMN, të cilët kanë vlerësuar se projektligj përmban implikime buxhetore.

Kryesuesi propozoi që Projektligj të shtyhet për një mbledhje të radhës , në mënyrë që grupi punues Parlamentar të përfundoj punë e saj, më pas Komisioni do të rishqyrtoi Raportin final të komisionit Funksional.

Elmi Reçica - ai tha se grupi Parlamentar me përkushtim ka shqyrtuar Projektligjin me amendamente të komisionit Funksional dhe është konstatuar se i njëjti duhet të rishikohet nga komisionet e përhershme.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar amendamentet e Projektligjit për statusin e të drejtave të dëshmorëve, dhe kanë vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore dhe se vërejtjet e tyre janë dorëzuar komisionit Funksional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Me theks të veçantë tha se raportin me amendamente të komisionit Funksional është shqyrtuar nga Qeveria dhe FMN-ja të cilët kanë vlerësuar se i njëjti ka implikime buxhetore.

Ai pajtohet me propozimin e kryesuesit, se komisioni do të pres raportin përfundimtar të grupit punues Parlamentar të cilët janë duke bërë ndryshime pozitive dhe më pas Komisioni do të procedojë miratimin e tij për Kuvend.

Kryesuesi konstatoi se me shumicë të votave komisioni mur qëndrim që Projektligji nr. 04/L-54, për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të shtyhet për një mbledhje të radhës.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Qeverinë e Kosovës. nr 04/ L-68, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjit për Qeverinë e Kosovës. nr 04/ L-68, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejte, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjit për Qeverinë e Kosovës. nr 04/ L-68 dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjin nr. 04/952 / L-61 për shitjen e banesave për të cilën ekziston e drejta banesore me raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor me ekspertizën e kryer të ekspertit të jashtëm nga Komisioni Evropian

Kryesuesi –Me theks të veçantë tha se Projektligj është i një natyre specifike, për këtë arsye Komisioni ka angazhuar ekspert nga Komisioni Evropian, të cilët kanë paraqit propozimet e tyre në formë të shkruar. Lidhur me analizën e ekspertizës Projektligjit i ndërrohet struktura mbi 50 %. Ai propozoi që raporti me amendamente të komisionit Funkcional së bashku me ekspertizën ti kthehet komisionit funksional për procedim të mëtejshëm.

Petar Miletic- në bazë të ekspertizës së ekspertit të Komisionit Evropian, shihet se e njëjta kalon përqindjen mbi 50 %, dhe tejkalon normat procedurale të amendamentimit të një Projektligji. Ai shprehu qëndrimin e tij se pajtohet me propozimin e kryesuesit që raporti i komisionit funksional së bashku me ekspertizën ti kthehet komisionit funksional për rishqyrtim.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, në mbledhjen e mbajtur më 18.11. 2011, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/952/L-61 për shitjen e banesave për të cilën ekziston e drejta banesore, me amendamentet e propozuara të komisionit funksional për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor dhe vendosi që komisionit funksional t'ia paraqes këtë:

R e k o m a n d i m

1. Komisioni ka shqyrtuar Raportin e komisionit funksional dhe amendamentet e propozuara dhe rekomandon tërheqjen e Projektligjit nr. 04/952/L-61 për shitjen e banesave për të cilën ekziston e drejta banesore nga procedura e mëtejshme, duke u bazuar në ekspertizën e ekspertëve të Komisionit Evropian, në aspektin e respektimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të komuniteteve, në pajtim me nenin 65.3 dhe shtojcën nr. 2.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.
2. Komisioni ka konstatuar dhe vlerësuar se me ndryshimin e mbi 50% të materies ligjore nga marrëdhëniet banesore pronësore-juridike që rregullohet me këtë Ligj, nuk arrihet qëllimi i nxjerrjes, kështu që propozon kthimin e të njëjtit, propozuesit, siç është paraparë me pikën 2 të këtij rekomandimi.

7. Shqyrtimi i detyrave të identifikuara të Komisionit nga Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Propozim-Planin e Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012 dhe nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni pas shqyrtimit të pikave kryesore të bazuara në përgjegjësitë e saja, njëzëri përkrahu Propozim-Planin e Veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012.

8. Të ndryshme

Kryesuesi – Si pikë e veçantë Komisioni do të shqyrtoj raportin e Komisionit për Legjislacion në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Ai tha se Komisioni ka ftuar kryetarin e Komisionit për Legjislacion z. Arben Gashi, dhe se i njëjti nuk iu është përgjigjur ftesës që të ofroj arsyetimin e duhur.

Komisioni për Legjislacion përsëri ka dal me Rekomandim me propozim se raporti i komisionit për Komunitete dhe Kthim ka bazën juridike, përveç amendamentit 3, sepse përmbajtja e tij përmban provizion detyrues që përfaqësimi në KKK të jetë deputeti nga radha e komuniteteve të përcaktuara.

Andaj ky provizion detyrues është në kundërshtim me qëllimin e projektligjit dhe kanë sugjeruar që Komisioni për Komuniteti dhe kthim ti përmbahet propozimin si në Ligj.

Lidhur me këtë çështje hapi debat.

Petar Miletic- ai ceku se komisioni fillimisht ka miratuar propozim amendamentin e grupit Parlamentar 6+, ku është konstatuar se i njëjti nuk prek dhe nuk cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Por ajo që tani është me rëndësi është raporti i dal nga Komisioni për legjislacion i cili udhëzon komisionin tonë që të tërheq amendamentin 3 me propozim që të mbetet si në projektligj.

Ai propozoi që Komisioni të jetë konstruktiv dhe ti përmbahet qëndrimit të komisionit për legjislacion.

Kryesuesi- Ai konstatoi se për arsye të njohura, grupit Parlamentar 6+ duhet ti tërheq amendamentet e tyre. Lidhur me këtë çështje fjalën ia dha deputetes z. Myfera.

Mufera Sinik – me theks të veçantë tha se grupi Parlamentar 6+ ka hartuar propozim e tyre dhe se të njëjtat janë miratuar si amendamente të komisionit funksional.

Në bazë të bisedës së hollësishme me përfaqësuesit e zyrës së ICO-së është arritur marrëveshja që amendamentet sërish duhet të riformulohen. Ajo pajtohet me qëndrimin e Komisionit që propozim amendamenti të mbetet si në Projektligj.

Në fund theksoi se projektligjet të cilat vijnë në leximi të parë fillimisht duhet të shqyrtohen nga komisioni jonë që të mos vihet në situata të tilla, siç është rasti me Projektligjin për sistemin e adresave.

Albert Kinolli – në fjalinë e tij tha se komisioni me shumicë të votave ka miratuar amendamentet e grupit Parlamentar 6+, dhe është marr qëndrimi që Raporti të procedohet për miratim në Kuvend.

Njëherit pajtohet me raportin e komisionit për legjislacion, ku ne pikën e parë thuhet se Projektligji ka bazën juridike në nenin 65,1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Por ai ka dilemë lidhur me pikën dy të këtij raporti se dispozita e udhëzon komisionin funksional të rishqyrtojë amendamentin 3 i cili përmban provizion detyrues dhe se është në kundërshtim me Projektligjin.

Ai propozoi që përsëri në Komision të ftohet kryetari i komisionit për legjislacion që të ofrojë arsyetimin e nevojshëm lidhur me rekomandimin e tyre.

Elmi Reçica – fillimisht komisioni ka dhënë pëlqimin për miratim të amendamentit të grupit Parlamentar 6+, duke përkrahur interesat në aspektin e respektimit dhe të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të komuniteteve Kosovare.

Gjegjësisht, në bazë të raportit të Komisionit për legjislacion, komisioni jonë është para një akti final. Ai konstatoi se i përmbahet qëndrimit të propozuar nga kryesuesi dhe z. Miletic, të fshihet amendamenti 3, dhe të mbetet si në Projektligj.

Komisioni për Komunitete dhe Kthim miratoi amendamentet në Projektligjin 04/L-20 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, dhe nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për Komunitete dhe Kthim me shumicë të votave miratoi amendamentet në Projektligj si Komision raportues dhe Funksional, dhe të njëjtat i ka konfirmuar si në vijim:

Amendamenti 1

Të behët harmonizimi i tekstit të projektligjit, versioni në gjuhën serbe dhe angleze, me tekstin në gjuhën shqipe.

Amendamenti 2

Neni 1, të fshihet

Kryesuesi- Me qëllim të vazhdimin të punës dhe të sigurimit të interesave vitale të komuniteteve, Komisioni ka vendosur të bëjë monitorimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës
Lidhur me këtë iniciativë komisioni ka hartuar Planin për monitorim të ligjit i cili kalonte pesë faza, për këtë fjalën ia dha kryetarit të grupit punues.

Elmi Reçica- tha se në bashkëpunim me përfaqësuesen e OSB-së znj Elita Vokshi dhe administratën e komisionit është diskutuar për organizimin e fazës së dytë lidhur me nismën e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Ne vazhdimësi të procesit të monitorimit të ligjit Komisioni do të organizojë vizita në terren dhe një dëgjim publik

E njoftoi Komisionin se do të organizohet vizita në Komunën e Graçanicës dhe Hani i Elezit ,dita e pare, Prizren dhe Mamush, dita e dyte.

Gjithashtu diskutoi se Komisioni do të mbajë dëgjim publik një ditë i cili do të mbahet në periudhën prej datës 10 deri 15 dhjetor.

Ne dëgjim publik do të ftohen zyrtaret komunal për komunitete të 15 komunave dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme që e mbështesin punën e komisionit.

Petar Miletic- ai diskutoi lidhur me menaxhimin e shpenzimeve buxhetore të Komisionit të cilat për nevojat e saja, këtë vit nuk janë arrit të realizohen.

Ai propozoi që komisioni të bëjë një vizitë në shtetin e Kroacisë me temën, sa respektohen të drejtat dhe interesat e komuniteteve jo shumicë.

Lidhur me kërkesën e vizitave jashtë shtetit, Komisioni duhet ti drejtohet me shkrim anëtarëve të kryesisë, të cilët janë kompetent për kërkesa të tilla.

Xheladin Hoxha- udhëheqës i divizionit për mbështetje të komisioneve Parlamentare, dha sqarim lidhur me mjetet buxhetore të cilat janë të dedikuara për Komisionet Parlamentare.

Për Komisionet funksionale janë të ndara 5.000 euro ndërsa për Komisionet e përhershme 10,000 euro. Këto mjete janë të rregulluara me një udhëzim administrativ të Kryesisë së Kuvendit e cila parasheh mundësin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, dëgjimeve publike, vizita në teren brenda territorit të Kosovës.

Sa i përket vizitave jashtë vendit ekziston një vendimi tjetër i kryesisë, ku komisioni duhet të sigurojë ftesën me agjendë, dhe se qëllimi i vizitës duhet të jetë në kuadër të bashkëpunimit Parlamentar, dhe më pas shkresa dërgohet në Kryesi.

Kryesuesi- ai dha sqarim se ka pas një takim me përfaqësuesit e IND-së lidhur me një vizitë jashtë shtetit por vendimi i Kryesisë është se mjetet buxhetore të komisionit mund të shpenzohen vetëm për vizita brenda Kosovës dhe për ekspertiza të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic